



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljena / Predato Received / Deliverty	22.06	2021	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednitca Org / Unit	3261/2021	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK			119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.778/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani anëtarë si dhe Ilire Mehmeti Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses ka shqyrtuar ankesën A.nr.778/2019, të datës 30.12.2019, të ankuesve

që të gjithë të përfaqësuar nga avokatët me adrese banimi rruga " Afrim Zhitia" p.n në komunën e Mitrovicës, sipas Aktgjykimit A.nr.606/20, të datës 31.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kundër organit të punësimit, Universiteti i Prishtinës në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 22.06.2021, mori këtë;

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar Ankesa A.nr.778/2019, e datës 30.12.2019, e ankuesve

Arsyetim

Ankuesit

me datën

30.12.2019 kane parashtruar ankesën me numër të protokollit 5952/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës .

Ankuesit me datë 31.10.2019 kanë parashtruar kërkesën me numër të protokollit 7/901 ne Universitetin e Prishtinës " Hasan Prishtina" ne Prishtinë, me pretendimet ankimore për pagën jubilarë për të punësuarit ne fakultetin Matematikore- Natyror sipas kontratës kolektive te nënshkruar ne mes te MASHT-it dhe SBASHK-ut të datës 18.04.2017.

Ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre avokatit dhe me datën 30.12.2019 kane parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimet ankimore kundër heshtjes se punëdhënësit ndaj kërkesës së ankuesve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil te Kosovës me datë 10.01.2020 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër te protokollit 72/2020, ndërsa me datën 15.10.2020 organi i punësimit ka përcjell përgjigjen në kërkesë me numër të protokollit 2103/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 06.02.2020 ka përcjellë njoftimin lidhur me ankesën A.nr.251/2019 të datës 30.12.2019 duke njoftuar palën që në mungesë të anëtarëve në Këshillit dhe me pa mundësi të merr vendim lidhur me ankesën e ankuesit munde të hap konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti Administrativ.

Ankuesit te pa kënaqur me njoftimin e datës 06.02.2020 të Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, përmes përfaqësuesit te tyre kane hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore ne Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore ne Prishtine/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 02.06.2021 me numër A.nr.606/20 , ka nxjerr Aktgjykimin me te cilin e ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e Këshillit te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , duke e detyruar që ne afat prej tridhjetë (30) ditë që të vendos lidhur me ankesën e ankuesve të parashtruar nga përfaqësuesi i tyre.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:**Ankesën e datës 30.12.2019 të parashtruar nga ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar me numër të protokollit 5952/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 30.12.2019 me numër te protokollit 5952/2019; Kërkesa e datës 31.10.2019 me numër 05/7/901; Kërkesa për përgjigje ne ankese e datës 10.01.2020 me numër te protokollit 72/2020; Njoftimi i datës 06.02.2020 me numër 289/2020; Përgjigja ne ankese e datës 15.10.2020 me numër te protokollit 2103/2020; Aktin e Emërimit të datës 27.04.2012 me numër Ref.nr.1/136 të ankuesit

Aktin e Emërimit të datës 12.11.2018 me numër Ref.nr.4/120 të ankueses

Aktin e Emërimit te datës 27.04.2012 me numër Ref.1/153 te ankueses

Aktin e

Emërimit të datës 27.04.2012 me numër Ref1/1/155 të ankuesit

Aktin e Emërimit

të datës 27.04.2012 me numër ref.1/155; Aktin e Emërimit të datës 27.04.2012 me numër Ref 1/155; Aktin e Emërimit te datës 27.04.2012 me numër Ref.nr 1/139 te ankueses

Aktin e Emërimit të datës 27.04.2012 me numër 1/134 te ankueses

Aktin e

Emërimit të datës 27.04.2012 me numër Ref. 1/151 te ankuesit

Aktin e Emërimit te

datës 27.04.2012 me numër Ref. 1/144 te ankueses

Akt Emërimi i datës



27.04.2012 me numër 1/133 te ankueses Aktin e Emërimit të datës 27.04.2012 me  
numër 1/132 te ankueses Aktin e Emërimit të datës 02/494 te datës 11.09.2012  
me numër Ref. 2/494 te ankuesit Aktin e Emërimit të datës 27.04.2012 me numër  
Ref. 1/137 te ankuese Aktin e Emërimit te datës 27.04.2012 me numër 1/143 te  
ankueses Aktin e Emërimit të datës 11.06.2013 me numër Ref.te ankueses  
Aktin e Emërimit te datës 27.04.2012 me numër Ref. 1/135 te ankueses ;  
Aktin e Emërimit të datës 27.04.2012 me numër Ref. 1/152 të ankueses ; Emalin e  
datës 10.01.2020 me te cilin përfaqësuesi i ankuesve deklarohet se ka hapur konflikt administrativ  
pranë Gjykatës Themelore ne Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar  
të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e grupit të ankuesve të  
përfaqësuar nga avokatë/ dhe është e pa lejuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave fillimisht ka analizuar Aktgjykimin, me numër  
A.nr.606/2020, të datës 31.05.2021,të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për  
Çështje Administrative, me të cilin Aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e  
anuluar njoftimin e datës 06.02.2020, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të  
Kosovës, si dhe duke e detyruar që në afatin prej tridhjet (30) ditësh Këshilli të vendos lidhur  
me ankesën e ankuesve;

si dhe te cilët i përfaqëson avokati dhe të  
datës 30.12.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar aktgjykimit A.nr.606/20 të  
datës 31/05/2021 si dhe ankesës A.nr.778/2019 të datës 30/12/2019, ka konstatuar se ankuesit  
që nga koha kur nuk kanë marrë përgjigje nga këshilli drejtues i universitetit "Hasan Prishtina"  
sipas shkresës së datës 31/10/2019 duke ju referuar edhe aplikimit të dispozitave të procedurës  
administrative sa i përket heshtjes, kanë pas të drejtë që të parashtrojnë ankesë në Komisionin  
për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në organin e punësimit në pajtim me dispozitat  
ligjore të Ligjit për Shërbimin Civil nga se kanë qenë të aplikueshme ende dispozitat ligjore të  
Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe ankuesit kanë pas të drejtë  
që të veprojnë në pajtim me dispozitat e nenit 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit  
Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që përcakton se: "2. Procedurat për  
zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e  
Kontesteve dhe të Ankesave dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës", andaj ankesa e ankuesve e  
datës 30.12.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
me numër të protokollit 5952/2021 është e para afatshme sepse ankuesit nuk i kanë shtjerr mjetet  
e brendshme juridike, andaj ankesa e ankuesve është e palejuar.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i  
Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente,  
Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej  
tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit  
administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda, A.nr.778/2019, datë 22/06/2021

Ilire Mehmeti Shaqiri

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



*Vendimi i dërgohet:*

- Përfaqësuesve të ankuesve dhe
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Prishtinës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së

